

Për : Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z.Muhaed Suliqi – Kryeshef Ekzekutiv në KRU Hidromorava Sh.A

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E  
 REKOMANDIMEVE**  
 të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra  
 Kombëtare e Auditimit

e	Komponenta e auditimit(ka pifulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Opinion i auditimit	Çështja A1 - Mbivlerësimi i shpenzimeve operative Testimet tona tregojnë se shpenzimet operative janë mbivlerësuar për vlerën 40,538€. Këto shpenzime kanë rezultuar si dalje e stoqeve nga depoja dhe janë regjistruar në klasën e shpenzimeve operative. Gjatë auditimit ne vërejtëm se këto stoqe kanë dalë nga depoja e donacioneve të cilat i ka financuar donatori (CDI Zvicerane) dhe në thelb janë materiale të	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se, bëhet klasifikimi i duhur i zërave në kontabilitet dhe njëkohësisht zëri i shpenzimeve të prezantohet drejtë në PFV në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabiliteti	Klasifikimi i zërave të kontabilitetit Korigjimi i zërit të shpenzimeve Ndarja e depos donacion me depon kryesore	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	Pajtohemi me të gjeturen ,kompania ka realizuar projekte që i përkasin fazës së V përmes CDI-së për Rehabilitim të rrjetit të ujësjellsit . Pasi që prej projekteve të filluara ka mbet Depo donacion dhe ka pjesë dhe gypa rezervë por mund të ketë edhe të projekteve , në të ardhmën do ta udheheqim jashtë

Për : Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z.Muhaed Suliqi – Kryeshef Ekzekutiv në KRU Hidromorava Sh.A

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E  
REKOMANDIMEVE**  
**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra  
Kombëtare e Auditimit**

e	Komponenta e auditimit(ka pitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Opinionit I auditimit	<b>Çështja A1 - Mbivlerësimi i shpenzimeve operative</b> Testimet tona tregojnë se shpenzimet operative janë mbivlerësuar për vlerën 40,538€. Këto shpenzime kanë rezultuar si dalje e stoqeve nga depoja dhe janë regjistruar në klasën e shpenzimeve operative. Gjatë auditimit ne vërejtëm se këto stoqe kanë dalë nga depoja e donacioneve të cilat i ka financuar donatori (CDI Zvicerane) dhe në thelb janë materiale të	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se, bëhet klasifikimi i duhur i zërave në kontabilitet dhe njëkohësisht zëri i shpenzimeve të prezantohet drejtë në PFV në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabiliteti	Klasifikimi i zërave të kontabilitetit Korigjimi i zërit të shpenzimeve Ndarja e depos donacion me depon kryesore	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	Pajtohem me të gjeturen ,kompania ka realizuar projekte që i përkasin fazës së V përmes CDI-së për Rehabilitim të rrjetit të ujësjellsit . Pasi që prej projekteve të filluara ka mbet Depo donacion dhe ka pjesë dhe gypa rezervë por mund të ketë edhe të projekteve , në të ardhmën do ta udheheqim jashtë

		cilat kanë jetëgjatësi mbi një vit, që plotësojnë kushtin për të qenë pasuri kapitale. Për më tepër, këto materiale janë prezantuar edhe tek zëri i "investimeve në vijim" në PFV.					depos së KRU Hidromorava.
2	Opinionimi I auditimit	<b>Çështja A2 -Mbivlerësimi i pasurive afatgjata</b> Saldo përfundimtare e zërit "Prona, Pajisjet dhe Impiantet" ishte prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare me vlerë 7,432,715€. Ky zë në shënimet shpjeguese ishte shpalosur në disa nën-zëra. Gjatë testimit të tyre kemi konstatuar se nën-zëri "rrjeti i ujësjellësit/ instalime teknike" ishte prezantuar në vlerë 5,589,737€, mirëpo vlera e tij ishte mbivlerësuar për 23,741€. Ky mbivlerësim ishte bërë me rastin e regjistrimit të pasurive të reja gjatë vitit të cilat ishin regjistruar së bashku me vlerën e TVSH-së në regjistrin e pasurive	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në regjistrin e pasurisë janë të regjistruara vetëm vlerat neto të tyre pa përfshirjen e tatimeve të rimbursueshme nga autoritetet përkatëse tatimore, dhe po ashtu të sigurojë që janë marrë veprimet korrigjues të vlerës së pasurive të mbivlerësuara	Regjistrimi rishtazi i vlerave neto duke përjashtuar tatimet dhe korrigjimet për vlerën e mbivlerësuar.	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	Veprimet janë ndërrmarrë dhe faturat janë korrigjuar ,mbivlerësimi i pasurive afatgjata ndërlidhet me çështjen A7 , do të korrigjohen gjitha regjistrimet e faturave për vlerën neto duke e përjashtuar TVSh-në deri në fund të vitit 2021 dhe do të prezantohet vlera reale e pasurive.
3	Opinionimi I auditimit	<b>Çështja A3-Nënvlerësimi i të hyrave të shtyra nga grantet</b> Në pasqyrën e pozicionit financiar të kompanisë, respektivisht në zërin e detyrimeve afatgjata (detyrimet ndaj grantit) me vlerë prej 5,609,514€, kompania nuk kishte përfshirë pagesën prej 115,084€, e cila ishte bërë gjatë vitit direkt nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për projektin "Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit Dobërçan". Poashtu vlera 83,805€ nuk i është ngarkuar këtij zëri si pasojë e kalkulimit jo të saktë gjatë hartimit të PFV-ve. Rrjedhimisht	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të regjistruar saktë vlerën e financimeve nga grantet dhe të bëhet një rishikim i shumave para miratimit të tyre me qëllim që prezantimi i PFV-ve të jetë i plotë dhe i drejtë.	Regjistrimi i saktë i dy vlerave të cilat janë regjistruar me një vlerë të përbashkët , korrigjimi i të hyrave të shtyra.	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	Në kartelen e llogarisë së të hyrave janë përfshirë pagesat 115,084.14 dhe 82,271.94 .

		nënvlerësimi i këtij zëri në PFV-të e 2020 gjithsejtë ishte 198,889€.					
4	Opinion i I auditimit	<p><b>Çështja A4-Mbivlerësimi i investimeve në vijim</b></p> <p>Saldo e zërit Investime në vijim në PFV është prezantuar me vlerë prej 1,153,302€, mirëpo, gjatë analizave tona kemi konstatuar se kjo shumë ishte mbivlerësuar për vlerën 168,331€, për projektet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Te projekti "Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit Dobërçan" ishte mbivlerësuar për vlerën 124,444€, si reflektim i regjistrimit të gabuar të TVSH-së dhe mos prezantimit të drejtë të avansit të dhënë në vitin paraprak;</li> <li>- Te projekti "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regionin e Gjilanit-zonat rurale" ishte mbivlerësuar për vlerën 35,379€ si reflektim i regjistrimit të gabuar të TVSH-së;</li> <li>- Te projekti "Ndërrimi i gypave të ujësjellësit për Gjilan, Viti dhe Kamenicë (lot 1 dhe lot 2)" ishte mbivlerësuar për vlerën 8,508€, si reflektim i regjistrimit të gabuar të TVSH-së dhe mos prezantimit të drejtë të avansit të dhënë në vitin paraprak</li> </ul>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në saldon e investimeve në vijim përfshihen vlerat e sakta duke përjashtuar vlerat e TVSH-së në prezantimin e këtij zëri. Po ashtu, të marrë veprime korigjuese për regjistrimet e identifikuar me gabime	Korigjimi i faturave me TVSH-në , regjistrimi me vlera neto	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	Mbivlerësimi i investimeve në vijim ndërlihet me çështjen e zgjidhur për mbipagesa gjate auditimit , deri në fund të vitit 2021 do të korigjohen regjistrimet.
	Opinion i I auditimit					31 dhjetor 2021	

5.	Opinioni I auditimit	<p><b>Çështja A5- Mos harmonizim i raportit të komisionit të inventarizimit të stoqeve me PFV-të</b></p> <p>Komisioni për inventarizimin e pasurisë në fund të vitit kishte bërë regjistrimin e pasurisë përfshirë këtu edhe stoqet dhe kishte përpiluar raportin final të inventarizimit. Ne krahasuam shumat e raportit të komisionit të inventarizimit me ato të pasqyrave financiare dhe konstatuam se ka diferenca në mes të raportit të komisionit dhe PFV-ve për vlerë e stokut. Sipas raportit të inventarizimit vlera e gjithmbarshme e stokut ishte 470,515€, gjersa në PFV ishte 435,523€. Rrjedhimisht vlera e stokut e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 34,991€.</p> <p><b>Çështja A6-Mbivlerësim i vlerës së stoqeve</b></p> <p>Komisioni për inventarizimin e pasurisë në fund të vitit kishte bërë regjistrimin e pasurisë përfshirë këtu edhe stoqet dhe kishte përpiluar raportin final të inventarizimit. Në këtë raport ata kishin përfshirë edhe vlerën e stoqeve të cilat janë financuar nga Donatori (CDI – Zvicëranë) dhe të cilat kanë dedikim projektet kapitale në të cilat donatori është bashkëfinancues i projektit. Këto stoqe lidhen me projekte kapitale të cilat përmbajnë pasuri me jetëgjatësi</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në vazhdimësi është duke u bërë harmonizimi i daljeve fizike të stoqeve me regjistrat kontabël në mënyrë që të shmangen diferencat të cilat janë paraqitur mes shënimeve kontabël dhe evidentimit fizik të stokut dhe të prezantohet vlera e saktë e stoqeve në PFV.</p> <p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë se regjistrimi i stoqeve bëhet në pajtim me politikat kontabël, bëhet rishikimi dhe harmonizimi i rezultateve të tyre dhe prezantohen drejtë në PFV.</p>	<p>Rekomandimi do të zbatohet dhe do të behet harmonizimi i daljeve fizike dhe raportit nga regjistrat kontabël .</p> <p>Regjistrimi do te behet ne pajtim me politikat kontabel, dhe do te behet ndarja e depos per stoqet te cilat nderlidhen me projektet kapitale nga CDI.</p>	<p>Zyrtari kryesor financiar</p> <p>Shefi i Kontabilitetit</p> <p>Zyrtarja e analitikes</p> <p>Zyrtari i sintetikës</p> <p>Zyrtari kryesor financiar</p> <p>Shefi i Kontabilitetit</p> <p>Zyrtarja e analitikes</p>	<p>31 Janar 2022</p> <p>31 dhjetor 2021</p> <p>31 Janar 2022</p>	<p>Gjatë përpilimit të raportit është gabuar nga kryetari i komisionit sepse mund ta shihni se në raport mungon edhe PUM depo , andaj mendoj se duhet të bazoheni në gjendjen e magazinës e cila është paraqitur në pasqyra dhe përputhet me gjendjen në softëer te cilat konsiderohen reale.</p> <p><b>Mbivlerësimi i vlerës së stoqeve ndërlidhet me A5 , do të udhëheqet depo donacion jashtë depos së KRU Hidromorava dhe do të rregullohen gjatë vitit 2021.</b></p>
6							

		mbi një vit, respektivisht e plotësojnë kushtin të jenë pasuri kapitale dhe nuk do të duhej të evidentoheshin si stoqe. Vlera e mbivlerësimit të stoqeve në PFV-të është 128,459€.					
7	Opinionii I auditimit	<b>Çështja B1-Mungesa e rivlerësimit të pasurive jo qarkulluese</b> Çështja e rivlerësimit të pasurive jo qarkulluese, ishte trajtuar edhe në raportin e auditimit financiar për vitin 2019, mirëpo sipas zyrtarëve të kompanisë, aksionari (Ministria e Ekonomisë) ka marr përsipër kontraktimin e një kompanie të licencuar për rivlerësim e pasurive për të gjitha kompanitë e ujësjellësit në Kosovë, por një gjë e tillë ende nuk është realizuar	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në pesë (5) vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16	Eshte parashikuar ne Planin e Biznesit Rivleresimi i asetëve , por per shkak te shtates se Pandemise nuk ka qene e mundur te realizohet.	Kryeshefi Ekzekutiv  Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	Revlerësimi I asetëve nuk është në kompetencë të KRU Hidromorava Sh.A duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Ndërrmarjet Publike por ekuzivisht kompetente për rivlerësimin e asetëve është aksionari respektivisht Ministria e Ekonomisë dhe e Ambientit, duke pas paraysh që ka qene rekomandim për vitin 2020 nuk ka mundur te arrihet andaj mendojme për vitin 2021 të realizohet
8	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë	<b>Çështja A7 -Mos prezantim i saktë i detyrimeve afatshkurta</b> Kompania arkëtimet në avancë nga konsumatorët që kishin parapaguar për shërbimet e ujit, i kishte prezantuar tek detyrimet tjera afatshkurta si parapagime të marra me vlerë 43,295€. Kjo shumë ishte mbivlerësuar për 9,058€, ku në këtë shumë përfshihen pranimet e parave nga	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se vlera e detyrimeve të njihet dhe prezantohet saktë në PFV si dhe të marrë masat e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël	Veprimet do të ndëmerren për pagesat e pa-identifikuara në bashkëpunim me thesarin dhe bankat dhe korrigjimet me të dhënat kontabël.	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	

		klientët e pa identifikuar dhe të cilat veç se janë të përfshira në të hyrat e kompanisë.					
9	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë	<p><b>Çështja B2 -Prezantimi jo saktë i llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme</b></p> <p>Kompania kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë, por analizat tona tregojnë se zëri i llogarive të arkëtueshme nuk ishte prezantuar drejtë. Diferenca e prezantuar në mes të viteve në pasqyrën e pozitës financiare nuk është e njëjtë me atë të prezantuar në pasqyrën e rrjedhës së parasë e cila është mbivlerësuar për vlerën 16,936€.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar harmonizimin e shënimeve në mes të departamenteve dhe të sigurojë korrigjimin e gabimeve në saldon e llogarive të arkëtueshme dhe në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme	Do të rishikohet harmonizimi dhe të bëhen korrigjimet e duhura për llogaritë e arkëtueshme.		31 dhjetor 2021 31 Janar 2022	
10	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë	<p><b>Çështja B3 -Nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme tregtare</b></p> <p>Zëri i llogarive të arkëtueshme në pozitën financiare ishte prezantuar në vlerën neto 3,731,392€, mirëpo gjatë analizimit të këtij zëri ne vërejtëm se ky zë ishte nënvlerësuar për 12,984€. Ndikimi i saldosit përfundimtar të nënvlerësuar ishte reflektuar edhe tek lëvizjet e aktiviteteve operative në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet modulit të shitjes me modulën e kontabilitetit, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.	Harmonizimi i të dhënave në mes të modulit të shitjes dhe modulit të kontabilitetit.	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021 31 Janar 2022	
11	Çështjet e kontabilitetit dhe të	<p><b>Çështja C1 -Vonesa në realizimin e projekteve kapitale</b></p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të ndërmerren veprimet e	Menaxhimi i kontratave do të bëhet sipas rekomandimit por gjithëmonë nuk mund të	Kryeshefi ekzekutiv	31 dhjetor 2021 31 Janar 2022	Me shfaqjen e Covid19, duke ditur se Kompanitë kanë

	pajtueshmëri së	<p>Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se kishte vonesa në realizimin e tri (3) projekteve kapitaleve prej pesë (5) muaj deri në dy (2) vite, në këto projekte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regionin e Gjilanit - zonat rurale” e nënshkruar në korrik 2017 ishte paraparë të përfundonte në 120 ditë, ndërsa ende nuk ka përfunduar;</li> <li>- “Ndërimi i Gypave të ujësjellësit për Gjilan, Viti dhe Kamenicë (lot 1 dhe lot 2)” e nënshkruar në shkurt 2019 dhe e paraparë të realizohet deri në dhjetor 2019, ende nuk është përfunduar; si dhe</li> <li>- “Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e Lumit në Dobërçan” e nënshkruar në tetor 2019, ishte parashikuar të përfundonte deri në dhjetor 2020, mirëpo ende nuk ishte përfunduar.</li> </ul> <p>Deri në përfundim të auditimit (qershor 2021) këto projekte ishin ende të pa përfunduara.</p>	nevojshme në menaxhimin dhe realizimin e projekteve për investime kapitale, në mënyrë që ekzekutimi i punëve të realizohet brenda afateve të parapara kohore.	përfashtohet mundësia në vonesë të realizimit të planit dinamik për shkak të rrethanave të ndryshme.	Menaxheri i kontrates  Shefi i Operatives  Zyrtari i Prokurimit		punuar me resurse të kufizuara njerzore, KRPP- ju ka mundësuar zgjatjen e afatit dinamik të kryerjes se punimeve
12	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmëri së	<p><b>Çështja A8 - Lidhja e kontratave jo sipas udhëzuesve të KRPP-së</b></p> <p>Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se tri (3) kontrata: “Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit në Dobërçan”: “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regionin e Gjilanit - zonat rurale” dhe “Zgjerimi i kapaciteteve me ujë të pijes në Lokacionin e FSK-s (Kazerma e</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për korrigjimin në rexhistrat kontabël dhe gjithashtu lidhja e kontratave të bëhet vetëm sipas udhëzuesve të KRPP-	Lidhja e kontratave do të bëhet sipas udhëzuesve të KRPP-së dhe gjithëmonë kontrata do të jenë konform ligjeve të aplikueshme me TVSH-në.	Kryeshefi Ekzekutiv  Zyrtari i prokurimit	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	Kontratat për projektet në fjalë janë të lidhura duke e marrë parasysh vendimin Shpjegues për aplikimin e ngarkesës së kundërt .



		<p>Forcave të sigurisë së Kosovës) dhe Lagjja Fidanishte-Gjilan” ishin lidhur jo sipas formularëve standard të përcaktuar nga KRPP. Kjo për shkak se, në nenin 3 të draft kontratave i ishte shtuar një paragraf i veçantë, paragrafi 3.3 i cili thekson”çmimi i kontratës është pa TVSH, konform ligjit të TVSH-së, që aplikohet për ngarkesë të kundërt”. Ky paragraf i shtuar në kontratë ka shtuar kostot në këto projekte kapitale të kontraktuara për pjesën e TVSH-së.</p> <p>Duke aplikuar këtë paragraf në kontrata kemi vërejtur se çdo fature iu është aplikuar TVSH-ja përmbi çmimin e kontraktuar dhe kjo ka reflektuar në rexhistrimet kontabël të zërave si pasuria, investimet në vijim dhe në përgjithësi ka ndikuar në prezantinim jo të saktë në PVF-të e 2020</p>	së.				
13	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë	<p><b>Çështja A9- Mos regjistrimi i drejtë i faturave për investime kapitale</b></p> <p>Gjatë testimeve tona kemi hasur në katër (4) raste kur kartelat financiare të furnitorëve për faturat e pranuar për investimet kapitale ishin regjistruar me vlera neto për pagesë duke zbritur përqindjen e avansit të dhënë duke zbatuar parimin e parasë së gatshme dhe jo vlerën e faturës të punëve që janë përfunduar sipas parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (parimit aktual). Ky regjistrim ka rezultuar në mos përputhje në mes vlerës</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë marrjen e veprimeve korrigjuese në mënyrë që të gjitha regjistrimet e faturave të bëhen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.	Faturat do të korrigjohen dhe do të bëhen regjistrimet e duhura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kosovës.	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Janar 2022	

		së faturës (vlerës reale të punëve të realizuara të projektit) me vlerën e regjistruar në kartelën e furnitorit. Rrjedhimisht, kjo ka shkaktuar mos prezantim të drejtë të investimeve në vijim për këto projekte kapitale të pa përfunduara, si dhe ka nënvlerësuar vlerën e pasurisë për projektet e përfunduara					
14	Çështjet e kontabilitetit dhe të Pajtueshmërisë	<b>Çështja A10- Mos veprimi i kompanisë për të funksionalizuar pikën e furnizimit me ujë</b> Gjatë ekzaminimit fizik të projektit është vërejtur se në shtëpizën të "Pusi 2" ndërtuar në lagjen Fidanishte, pjesa elektrike ishte djegur tërësisht dhe ishte jashtë funksionit. Kompania kishte formuar një komision për evidentimin e dëmit të shkaktuar dhe kishte vlerësuar dëm financiar në vlerë 4,068€. Projekti ishte pranuar teknikisht në muajin dhjetor 2020, Garancioni i sanimit të dëmeve ishte një (1) vit pas pranimit teknik të projektit.. Kompania edhe pas 6 muajsh nga djegia e shtëpizës nuk kishte arritur që të fus në funksion këtë pikë të furnizimit me ujë.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë marrjen e veprimeve të nevojshme për sanimin e dëmeve dhe funksionalizimin e pikës së furnizimit me ujë.	Veprimet e nevojshme do të ndërmerren konform Rekomandimit të ZKA-së.	Kryeshefi Ekzekutiv Shefi i operativës Menaxheri i projektit	31 dhjetor 2021	Menaxhment i KRU Hidromorava konsideron se hapat e reagimit për këtë çështje janë bërë të menjëhershme e në kohe reale menjëherë pas njoftimit të problemit dhe kjo mund të vërtetohet edhe në raportin e holleësishem që ishte doëzuar ekipit të Auditorve .
15	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë	<b>Çështja B4 - Pranimet e parave nga konsumatorët e pa identifikuar</b> Hidromorava në fund të vitit 2020 në llogarinë e saj kishte 9,058€ pagesa nga konsumatorë të paidentifikuar, të cilat nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e shlyera ndaj kompanisë. Pagesat që kryhen nga konsumatorët mbesin të	Bordi i Drejtorëve të sigurojë krijimin e një komisioni të brendshëm i cili do të bëjë identifikimin e konsumatorëve dhe mbylljen e llogarisë pezull. Rrjedhimisht, konsumatorët të cilët i kanë paguar obligimet e tyre dhe mjetet e të cilëve janë në	Veprimet do të ndërmerren dhe komisioni do të formohet për mbylljen e llogarive pezull.	Zyrtari kryesor financiar  Shefi i Kontabilitetit  Zyrtarja e analitikes	31 dhjetor 2021  31 Qershor 2022	Meqenëse kemi te gjeturë nga viti i kaluar ne i kemi vepruar sipas rekomandimeve por pandemia na bëri të pamundur zgjidhjen e kësaj çështje dhe prap e kemi të vështire për ti identifikuar deri në fund të vitit mund të kaloj edhe pas vitit 2021.

		paidentifikuara deri në momentin kur konsumatori i cili ka kryer pagesën, lajmërohet për shlyerjen e borxhit.	llogarinë "Pagesa të paidentifikuara" të ju zbriten klientëve nga kartelat e tyre individuale.				
16	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë së	<p><b>Çështja A11- Prokurime të shpeshta me vlera minimale</b></p> <p>Gjatë testeve tona të listës së prokurimeve/kontratave të realizuara me procedurat me vlerë minimale (nga 100€ deri 1,000€) kemi vërejtur se gjatë vitit 2020 janë realizuar 70 procedura të tilla, ku janë shpërblyer nga disa herë operatorët e njëjtë për projekte/furnizime të njëjta si:</p> <p>"Shërbime softueri" një (1) operator është kontraktuar njëmbëdhjetë (11) herë në vlerë totale 10,688€;</p> <p>"Furnizimi dhe shërbimi me pompa" një (1) operator është shpërblyer shtatë (7) herë në vlerë totale 5,478€; dhe</p> <p>"Furnizim me pjesë të ujësjellësit" një (1) operator është kontraktuar pesë (5) herë në vlerë totale 4,435€.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se bëhet identifikimi i nevojave për furnizime nga të gjitha njësitë kërkuese dhe të njëjtat përfshihen në planin vjetor të prokurimit. Përpilimi adekuat i planeve për furnizime ndihmon në zhvillimin e procedurave adekuate dhe shtim të vlerës për para.	Planifikimi do të rishikohet me shumë kujdes dhe të bëhet sipas nevojave , do të prezentohet në planin e biznesit në mënyrë që furnizimet me vlera minimale të reduktohen maksimalisht.	Kryeshefi Ekzekutiv Zyrtaari kryesor financiar	31 dhjetor 2021 31 Janar 2022	-Sa i përket shërbimeve të softverit të shpeshta ,kjo ka ndodhe për shkak se lënde ka qenë ne OSHP (për shkak të specifikave të saj dhe Ankesave të bëra nga Operatorët ekonomik) andaj ne jemi detyruar pa vullnetin tonë të procedojm me procedurën minimale 100-1000 për të bërë zgjidhje.
17	Çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë së	<p><b>Çështja A12- Njohja e parapagimit të sigurimit të automjeteve si shpenzim</b></p> <p>Sipas regjistrave kontabël të kompanisë, shuma në vlerë prej 4,424€ e paguar për sigurimin e automjeteve, është regjistruar si shpenzim i periudhës përderisa do të duhej të regjistrohej si parapagim në fillim të vitit dhe</p>	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që zyra e financave regjistrojnë transaksionet në mënyrë të drejtë duke interpretuar drejtë standardet e kontabilitetit.	Do të shtohet kontroll e mbrendshme për regjistrimet e transaksioneve në përputhje me SNK-në dhe me shtimin e stafit të rinj të evitohen në tërësi.	Zyrtari kryesor financiar	31.09.2021	Zyrtari ka gabuar në regjistrimin e transaksionit, do të rregullohet regjistrimi .

		pastaj në fund të vitit të bëhen rregullimet e nevojshme, duke i njohur si shpenzime vetëm ato shuma që i takojnë periudhës raportuese, ndërsa pjesa tjetër të regjistrohën si parapagim (pasuri).					
--	--	--	--	--	--	--	--